Une Violeta Haloci eksperte kontabel e autorizuar me nr license 83, caktuar me shkresen nr. 4780/1 date 26 07 2011 te Ministrise se Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes, si aksionere e vetme e kesaj shoqerie, per auditimin e bilancit te reformuar pas ndryshimit te kapitalit te shoqerise duke mbyllur humbjen e trasheguar dhe humbjen e vitit ushtrimor 2010 si dhe shtimin me vleren e truallit te SHa .Per te kryer misionin tim u mbeshteta ne kete dokumentacion:

- Ne shkresen numur 4780/1 date 26 07 2011 te Mistrise Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes.
- Ligji "Per shoqerite tregetare"
- Bilanci financiar per vitin ushtrimor 2010 mbyllur ne 31 12 2010.
- Miratimi I bilancit nga Keshilli Mbikqyres.
- Materialet per zvogelimin e kapitalit per heqjen e nje objekti edhe sipas QKR dt 15 08 2011.

Statusi I shoqerise si dhe gjithe dokumentacioni perkates.

Shoqeria "Trajtimi I Studentave nr. 1 " SHA Tirane eshte krijuar si SHA me vendimin e gjykates se rrethit gjyqesor Tirane nr. 33625 ne daten 02 06 2005 me Kapital themeltar 1 590 545 603 000 leke te ndare ne 1 590 545 603 aksione me nga 1000 leke vlera e nje aksioni me aksioner te vetem shtetin perfaqesuar nga Ministria Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes.Me ndryshimet e bera ne kapital te shoqerise ne periudha te ndryshme aktualisht kapitali I shoqerise edhe sipas ekstrateve te QKR –se eshte 1 521 238 324 leke I ndare ne 1 521 238 aksione me nga 1 000 leke vlera e nje aksioni.

Selia e shoqerise SHA" trajtimi I Studentave nr. 1" eshte ne Tirane.

Organi drejtues I shoqerise eshte Asambleja e Aksionerit dhe organi mbikqyres eshte Keshillit Mbikqyres I cili ka zgjedhur Drejtorin z. Bujar Brovima .

Objekt I veprimtarise se Shoqerise ne krijimin e saj eshte:Trajtimi ne fjetore dhe menca I studenteve te Universitetit te Tiranës etj qe lidhen me kete..

Shoqeria eshte e regjistruar prane organeve tatimore ne degen e Tatim Taksave Tirane me NIPT K 51814005N .



## OPINIONE PER VLERESIMIN E AKTIVIT

Ne postin e bilancit active monetare ne vleren neto 26 506 496 leke perfshihet gjendja e likujditeteve me 31/12/2010,dhe nga kontrolli I kryer rezulton se ajo perputhet me ekstraktet kontabel perkatese si vijon:

Likujditete ne banke 26 506 496 Leke

Si konkluzion likujditetet qe rezultojne gjendje me 31/12/2010 perbejne nje aktiv real per shoqerine.

Ne postin e bilancit aktive te tjera financiare afatshkurtera ne shumen 113 843 793 leke ne baze te verifikimeve qe ne kryem rezulton se vlera e pasqyruar ne bilancin ushtrimor 2010 rakordon me inventarin kontabel te llogarise perkatese. Kjo perfaqeson vleren e klienteve te pa arketuar dhe detyrime te tjera te paarketuara

**INVENTARI** ne Shumen 56 106 525 leke perfaqeson gjendjen e materialeve dhe inventarit te imet ne 31 12 2010 ne magazine . Kjo gjendje eshte e kuadruar me inventarin dhe kontabilitetin. Per kete ajo perben nje aktiv real per ndryshimin e kapitalit.

**AKTIVE AFATGJATA** ne Shumen 8 314 940 188 leke perfaqeson vleren neto truallit, te ndertesave, te makinerive dhe paisjeve , te inventarit ekonomik, te paisjeve informatike, dhe te aktiveve te tjera afatgjata te gjitha .sipas inventarit perkates .Ketur perfshihet vlera e aktiveve ne 31 12 2010 dhe ndryshimi ne 15 gusht 2011.

Keto aktive jane me dokumentacion te rregullt dhe inventar fizik. Per sa me siper ato perbejne nje aktiv real per shoqerine .

Ne perfundim per efekt te ndryshimit te kapitalit te shoqerise vlera e aktivitet real qe duhet te merret ne konsiderate rezulton:

-Vlera e aktivitet totale me ndryshimin ne gusht 2011 /	8 512 044 353 leke
-Vlera e aktivitet fiktiv	nuk rezulton
-Vlera e aktivitet real	8 512 044 353 leke

## OPINIONE MBI PASIVIN E BILANCIT

Ne kapitalet e veta te shoqerise vlera prej 8 186 458 288 leke perfaqeson kapitalet e veta te cilat perbehen nga vlera e



-Kapitalit themeltar	1 521 238 235 leke
- Prime te lidhura me kapitalin	6 661 103 324 leke
- Rezerve rivleresimi	208 273 341 leke
- Rezerva te tjera	2 048 469 leke
- Humbje e mbartur ( Akumuluar )	179 791 543 leke
- Humbje e vitit ushtrimor 2010	26 413 538 leke

Me verifikimin e kryer per kapitalet e veta te shoqerise rezulton se Humbje te vitit ushtrimor 2010 shoqeria pasqyron humbjen e krijuar ne shoqeri nga aktiviteti I shoqerise, kjo humbje eshte e barabarte me ate te pasqyruar ne pasqyren e llogarise humbje dhe fitim.

**Ne postin e bilancit Pasive Afatshkurtera** ne Shumen 47 896 592 leke perfaqeson detyrimet ndaj furnitoreve,detyrimet per sigurimet shoqerore , detyrimet per tapin dhe detyrime te tjera . Te gjitha detyrimet jane te njohura dhe te pagueshme,

**Pasive Afatgjata** ne Shumen 277 689 473 leke perfaqesojne grandet ne Shumen 175 176 045 leke dhe provigjonet e krijuara ne Shumen 102 513 428 leke per klientet e paarketueshem

## **NDRYSHIMI I KAPITALIT TE SHOQERISE**

Behet duke e pakesuar nepermjet kalimit te humbjes se mbartur dhe humbjes se ushtrimit te vitit 2010 dhe rritje nepermjet vleres se truallit te shoqerise.

Veprimi kontabel :

Llog . Humbje e mbartur	kreditohet	ne Shumen	179 791 543 leke
Llog. Humbje e vitit 2010	kreditohet	ne Shumen	26 413 538 leke
Llog. Prime lidhur me kapitalin ( Vlera e truallit )	Debitohet	ne Shumen	6 661 103 324 leke
<b>Shuma totale</b>			<b>6 454 898 243 leke</b>
Llogaria Kapitali	Kreditohet	ne Shumen	6 454 897 765 leke
Llogaria rezerva	Kreditohet		478 leke

Diferenca prej 478 leke kalon ne rezerva te tjera per efekt te rumbullakimeve te shifrave te kapitalit.



Duke patur parasysh se kam permbushur misionin tim per vleresimin e aktiveve dhe pasiveve te shoqerise bazuar ne vlerat e bilancit date 31 12 2010 dhe ndryshimit te bere ne gusht 2011 vertetoj se llogarite kontabile shprehin vleren pasurore reale te shoqerise qe perfaqesohet nepermjet kapitalit te saj themeltar.

Si konkluzion kapitali themeltar I shoqerise nga shuma prej 1 521 238 235 leke I ndare ne 1 521 238 aksione me 1000 leke vlera e nje aksioni, me vleresimet tona bazuar ne legjislacionin perkates duke pakesur me humbjen dhe duke shtuar vleren e truallit te shoqerise pra gjithesj pakesim prej 206 205 081 leke humbje e mbartur dhe humbje e vitit 2010 dhe shtim 6 661 102 846 leke vlera e truallit te shoqerise, pasi I kemi zbritur 478 leke per rumbullakim shifrash, kapitali behet 7 976 136 000 leke I ndare ne **7 976 136** aksione me nga **1000** leke vlera e nje aksioni.

Bashkangjitur ketij relacioni eshte dhe bilanci per percaktimin e vleres se ndryshimit te kapitalit themeltar.

### **PJESMARRJA ME KAPITALIN E SHOQERISE**

Pas ndryshimit te kapitalit te shoqerise pjesmarja ne kapital rezulton si vijon:

Ortak	Numuri I aksioneve	vlera kapitalit Themeltar	%	vlera e nje aksioni
1	<b>7 976 136</b>	<b>7 976 136 000</b>	<b>100</b>	<b>1.000</b>

Ky mision I ndryshimit te kapitalit u krye ne baze te kerkeses aksionerit te shoqerise.

### **EKSPERTE KONTABEL AUTORIZUAR**

**Violeta Haloci**



**Bilanci I reformuar pas ndryshimit te kapitalit themeltar te  
shqerise Trajtimi I Studentave nr. 1 Tirane Tetor 2011**

Nr.	Akktivet	Bilanci me ndryshimin e fundit te kapitalittetor 2011	Bilanci me ulje kapitali ne 15 08 2011	Bilanci 31 12 2010
I	<b>AKTIVET AFATSHKURTRA</b>	<b>196,456,814</b>	<b>196,456,814</b>	<b>196,456,814</b>
	<b>1 Aktivet monetare</b>	<b>26,506,496</b>	<b>26,506,496</b>	<b>26,506,496</b>
	> Banka	26,506,496	26,506,496	26,506,496
	> Arka		0	0
	<b>2 Derivative dhe aktive te mbajtura per tregtim</b>			
	<b>3 Aktive te tjera financiare afatshkurtra</b>	<b>113,843,793</b>	<b>113,843,793</b>	<b>113,843,793</b>
	> Kliente per mallra, produkte e sherbime	102,619,770	102,619,770	102,619,770
	> Debitore, Kreditore te tjere		0	
	> Tatim mbi fitimin	736,400	736,400	736,400
	> TVSH			
	> Te drejta e detyrime per cdemtime	4,583,500	4,583,500	4,583,500
	> Te tjera nga persona dhe personeli	5,904,123	5,904,123	5,904,123
	> Te tjera (Dogana)			
	<b>4 Inventari</b>	<b>56,106,525</b>	<b>56,106,525</b>	<b>56,106,525</b>
	> Lendet e para	17,439,127	17,439,127	17,439,127
	> Inventari i imet	38,667,398	38,667,398	38,667,398
	> Prodhim ne proces	0		
	> Produkte te gatshme	0		
	<b>5 Aktive biologjike afatshkurtra</b>			
	<b>6 Aktive afatshkurtra te mbajtura per rishitje</b>			
	<b>7 Parapagime dhe shpenzime te shtyra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	
	> Shpenzime te periudhave te ardhshme			
II.	<b>AKTIVET AFATGJATA</b>	<b>8,315,587,539</b>	<b>8,314,940,188</b>	<b>8,440,856,229</b>
	<b>1 Investimet financiare afatgjata</b>			
	<b>2 Aktive afatgjata materiale</b>	<b>8,314,940,188</b>	<b>8,314,940,188</b>	<b>8,440,856,229</b>
	> Toka (rruge te brendeshme)	23,279,532	23,279,532	23,279,532
	> Vlera e truallit	6,661,103,324	6,661,103,324	6,733,603,000
	> Ndertesa	1,421,577,056	1,421,577,056	1,474,993,421
	> Makineri dhe pajisje	35,158,968	35,158,968	35,158,968
	> Instalime nentokesore, makineri dhe paisje	134,191,080	134,191,080	134,191,080
	> Mjete transporti	4,787,111	4,787,111	4,787,111
	> inventar ekonomik	29,057,273	29,057,273	29,057,273
	> Paisje informatike	1,304,036	1,304,036	1,304,036
	> Pyjet plantacionet	4,481,808	4,481,808	4,481,808
	<b>3 Aktivet biologjike afatgjata</b>			
	<b>4 Aktivet afatgjata jomateriale</b>	<b>647,351</b>	<b>647,351</b>	<b>647,351</b>
	<b>5 Kapitali aksioner i pa paguar</b>			
	<b>6 Aktive te tjera afatgjata</b>			
	<b>TOTALI I AKTIVEVE (I+II)</b>	<b>8,512,044,353</b>	<b>8,512,044,353</b>	<b>8,637,960,394</b>



**Bilanci I rreformuar pas ndryshimit te kapitalit themeltar te  
hoqerise Trajtimi I Studentave nr. 1 Tirane Tetor 2011**

Nr.	PASIVET DHE KAPITALI	Bilanci me ndryshimin e fundit te kapitalitetor 2011	Bilanci me ulje kapitali ne 15 08 2011	Bilanci 31 12 2010
I	<b>PASIVET AFATSHKURTRA</b>	<b>47,896,592</b>	<b>47,896,592</b>	<b>47,896,592</b>
	1 Derivativet			
	2 Huamarrjet	0		
	> Overdraftet bankare			
	> Huamarrjet afatshkurtra			
	3 Huat dhe parapagimet	47,896,592	47,896,592	47,896,592
	> Te pagueshme ndaj furnitoreve	20,422,383	20,422,383	20,422,383
	> Te pagueshme ndaj punonjesve			
	> Detyrime per Sigurime Shoq.Shend.	6,034,258	6,034,258	6,034,258
	> Detyrime tatimore per TAP-in	2,452,416	2,452,416	2,452,416
	> Detyrime tatimore per Tatim Fitimin			
	> Detyrime tatimore per TVSH-ne			
	> Detyrime tatimore per Tatimin ne Burim			
	> Kreditore bte tjere ( objekte me qera) shte	9,274,853	9,274,853	9,274,853
	> Detyrime te tjera	1,407,754	1,407,754	1,407,754
	> Debitore dhe Kreditore te tjere	8,304,928	8,304,928	8,304,928
	4 Grantet dhe te ardhurat e shtyra			
	5 Provizionet afatshkurtra			
II.	<b>PASIVET AFATGJATA</b>	<b>277,689,473</b>	<b>277,689,473</b>	<b>277,689,473</b>
	1 Huat afatgjata	0	0	
	> Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare			
	> Bono te konvertueshme			
	2 Huamarrje te tjera afatgjata	0		
	3 Grantet dhe te ardhurat e shtyra	175,176,045	175,176,045	175,176,045
	4 Provizionet afatgjata	102,513,428	102,513,428	102,513,428
	<b>TOTALI I PASIVEVE (I+II)</b>	<b>325,586,065</b>	<b>325,586,065</b>	<b>325,586,065</b>
III	<b>KAPITALI</b>	<b>8,186,458,288</b>	<b>8,186,458,288</b>	<b>8,312,374,329</b>
	1 Aksionet e pakices (PF te konsoliduara)			
	2 Kapitali aksionereve te shoq.meme (PF te kons.)			
	3 Kapitali aksionar	7,976,136,000	1,521,238,235	1,574,654,600
	4 Primi i aksionit ( Vlera e truallit)		6,661,103,324	6,733,603,000
	5 Rezerve rivleresimi	208,273,819	208,273,341	208,273,341
	6 Rezervat statutore			
	7 Rezervat ligjore			
	8 Rezervat e tjera	2,048,469	2,048,469	2,048,469
	9 Fitimet e pa shperndara		-179,791,543	-179,791,543
	10 Fitimi (Humbja) e vitit financiar		-26,413,538	-26,413,538
	<b>TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT (I+II+III)</b>	<b>8,512,044,353</b>	<b>8,512,044,353</b>	<b>8,637,960,394</b>



Nr. 419/1 prot/Tiranë, më 28.07.2020

Nr. 55/1 prot/Tiranë, më 28.07 2020

**MARRËVESHJE PËR BASHKIMIN ME PËRTHITHJE TË SHOQËRIVE REZIDENCA  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 SH.A. DHE "NDËRMARRJA E TRAJTIMIT TË  
STUDENTËVE NR. 3" SH.A.**

Sot, më datë 28.07.2020, në Tiranë, hartohet kjo projekt-marrëveshje për bashkimin me përthithje ndërmjet palëve të mëposhtme:

**1. "REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1"**, Sh.a., shoqëri aksionare, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me numër identifikimi NIPT K51814005N, me seli në Arben Broci, Qyteti Studenti, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori Znj. Anila Shehu, këtu e në vijim referuar ndryshe si "**Shoqëria përthithëse**"/ "**RSU Nr. 1**";

dhe

**2. "NDËRMARRJA E TRAJTIMIT TË STUDENTËVE NR. 3"** Sh.a., shoqëri aksionare, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me numër identifikimi NIPT K51726022O, me seli në Godina Nr.6, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Tiranë, përfaqësuar nga Administratori Z. Ndue Ndoci, këtu e në vijim referuar ndryshe si "**Shoqëria e përthithur**"/"**NTS Nr. 3**".

Palët bien dakord për sa më poshtë:

**1. Baza ligjore**

Kjo Marrëveshje formulohet në bazë të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar ("**LSHT**"), Ligjit nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" të ndryshuar Ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

**2. Objekti i Marrëveshjes**

Objekti i kësaj marrëveshje është bashkimi nëpërmjet përthithjes i shoqërisë "Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr. 3" Sh.a. nga shoqëria "Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1" Sh.a..

"Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr. 3" Sh.a. (shoqëria e përthithur) do të përthithet nga shoqëria "Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1" Sh.a. (shoqëria përthithëse), sipas kushteve dhe termave të kësaj marrëveshjeje.

Kjo marrëveshje hartohet në përputhje e zbatim të vendimeve të asamblesë së përgjithshme të aksionerëve të lëshuar nga të dy shoqëritë palë.

### **3. Forma, emërtimi, selia dhe të dhënat e shoqërive pjesëmarrëse në bashkimin me përthithje.**

1. Shoqëria aksionare "Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr. 3" Sh.a., e cila në këtë operacion bashkimi do të jetë shoqëria e përthithur, rezulton me këto të dhëna:

- Shoqëria "Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr. 3" Sh.a., është regjistruar si person juridik më datë 26/05/2005 dhe identifikohet nga numri NIPT K517260220;
- Forma e shoqërisë "Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr. 3" Sh.a. është shoqëri aksionare (sh.a.);
- Emërtimi i shoqërisë është Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr. 3" Sh.a.;
- Selia e shoqërisë ndodhet në adresën Godina Nr.6, Universiteti Bujqësor i Tiranës;
- Aksionari i Vetëm i shoqërisë është Bashkia Tiranë e cila zotëron kapitalin themeltar në masën 100% të tij;
- Administrator i shoqërisë është Z. Ndue Ndoci;
- Kapitali themeltar i shoqërisë para bashkimit me anë të përthithjes është 154.743.000,00 Lekë.

2. Shoqëria aksionare "Rezidenca Studentore Universitare nr. 1" Sh.a., e cila në këtë operacion bashkimi do të jetë shoqëria përthithëse, rezulton me këto të dhëna:

- Shoqëria "Rezidenca Studentore Universitare nr. 1" Sh.a., është regjistruar si person juridik më datë 26/05/2005 dhe identifikohet nga numri NIPT K51814005N;
- Forma e shoqërisë "Rezidenca Studentore Universitare nr. 1" Sh.a. është shoqëri aksionare (sh.a.);
- Emërtimi i shoqërisë është "Rezidenca Studentore Universitare nr. 1" Sh.a.
- Selia e shoqërisë ndodhet në adresën Arben Broci, Qyteti Studenti, Tiranë;
- Aksionari i Vetëm i shoqërisë është Bashkia Tiranë e cila zotëron kapitalin themeltar në masën 100% të tij;
- Administrator i shoqërisë është Znj. Anila Shehu.
- Kapitali themeltar i shoqërisë para bashkimit me anë të përthithjes është 7.976.136.000,00 Lekë.

### **4. Motivet, qëllimet dhe kushtet e bashkimit**

**I. Motivi i bashkimit me përthithje:** Duke qenë se shoqëritë "Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1 Sh.a. dhe "Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr. 3" Sh.a kanë të njëjtin aksioner të vetëm,



Bashkinë Tiranë, ushtrojnë objekt të ngjashëm veprimtarie si dhe duke konsideruar se nga dëmet e shkaktuara nga tërmeti i Nëntorit 2019, Konvikti i administruar nga "Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr. 3" Sh.a. nuk ekziston më dhe kjo e fundit aktualisht nuk ushtron asnjë lloj veprimtarie, për lehtësi operimi palët nëpërmjet kësaj projekt-marrëveshje kërkojnë bashkimin me përthithje në një shoqëri ekzistuese që do të jetë Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1 Sh.a..

Në këto kushte palët dëshirojnë që të realizohet bashkimi me përthithje të shoqërisë "Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr. 3" Sh.a. që do të përthithet nga shoqëria Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1 Sh.a. Aksionari i Vetëm i shoqërive vlerëson në parim që të realizohet ky proces i bashkimit me përthithje.

**II. Qëllimi i bashkimit** me përthithje është që të evitohen shpenzimet e tepërta duke qenë se shoqëria e përthithur nuk mund të ushtrojë veprimtarinë e saj dhe duke u bashkuar në një shoqëri të vetme mund të arrihet një efikasitet ekonomik-financiare për të dy shoqëritë.

Kushtet e bashkimit me përthithje të shoqërisë "Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr. 3" Sh.a. e cila do të përthithet nga shoqëria "Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1" Sh.a., janë si më poshtë vijon:

- Shoqëria "Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr. 3" Sh.a. që do të përthithet do të transferojë në mënyrë universale pasuritë e saj, të cilat do të rezultojnë sipas bilancit kontabël të mbyllur më datë 31.12.2019 dhe në këmbim të kontributit të aksionarit të vetëm të shoqërisë "Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr. 3" Sh.a., i cili do të marrë aksione në kapitalin e shoqërisë përthithëse. Në sensin juridik dhe sipas ligjit, shoqëria e përthithur "Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr. 3" Sh.a. do të priset pa likuidim.
- Shoqëria "Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1" Sh.a., do të përthithë vlerën pasurore që do të transferohet nga Shoqëria "Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr. 3" Sh.a. që do të rezultojë sipas bilancit kontabël të mbyllur më datë 31.12.2019.
- Pas operacionit të bashkimi me përthithje shoqëria ekzistuese "Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1" Sh.a., do të mbajë të njëjtin emërtim, do të ketë të njëjtin administratror dhe seli të regjistruar.
- Të gjitha transaksionet të realizuara gjatë vitit 2020 deri në momentin e bashkimit, nga ana e shoqërisë së përthithur pavarësisht nga rezultati që japin janë të pranueshme nga shoqëria përthithëse.

**III. Caktimi dhe vlerësimi i aktivitetit dhe pasivitetit që është parashikuar t'i kalojë shoqërisë përthithëse.**

Në bazë të nenit 215, pika 1 e LSHT, Shoqëria "Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr. 3" Sh.a. do të transferojë shoqërisë përthithëse "Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1" Sh.a., kundrejt akisoneve të kësaj të fundit, të gjitha aktivitetet dhe pasivitetet sipas Bilancit të datës së fundit kontabël,

duke marrë në konsideratë edhe cdo ndryshim të ndodhur deri në datën e mbylljes së bashkimit me përthithje.

Aktivitet dhe pasivitet përfshijnë cdo të drejtë dhe detyrim të njohur si të tillë në pasqyrat financiare dhe cdo marrëdhënie tjetër me të tretë deri në datën e ekzekutimit të mbylljes.

Aktivitet dhe detyrimet tatimore të NTS Nr. 3 (shoqëria e përthithur), sic rezultojnë në pasqyrat financiare të datës së fundit kontabël, do t'i transferohen RSU Nr. 1 (shoqëri përthithëse) si të gjitha llojet e tjera të aktiveve dhe detyrimeve.

Për pasuritë e paluajtshme, RSU Nr. 1 do të bëjë regjistrimin pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Marrëdhënie të caktuara kontraktuale të shoqërisë së përthithur NTS Nr. 3 me palë të treta, nëse konstatohet se nuk do i shërbejnë RSU Nr. 1 pas bashkimit me përthithje, mund të vendoset të zgjidhen para ose pas datës së regjistrimit të bashkimit me përthithje, duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe parashikimet e këtyre kontratave për zgjidhjen e tyre.

- Shoqëria "Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr. 3" Sh.a. ("**NTS Nr. 3**") do të përthithet dhe do të transferojë në mënyrë universale pasuritë e saj, të cilat do të rezultojnë sipas bilancit kontabël të mbyllur më datë 31.12.2019.

Të dhënat e tjera në mënyrë sintetike të shoqërisë që do të përthithet deri më datë 31.12.2019 janë si më poshtë vijon:

- Kapitali themeltar prej 154.743.000,00 Lekë;
- Numri i aksioneve 154.743,00 aksione;
- Vlera nominale e një aksioni 1.000,00 Lekë secila

- Shoqëria "Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1" Sh.a. ("**RSU Nr. 1**"), që do të jetë shoqëria përthithëse sipas bilancit kontabël të mbyllur më datë 31.12.2019 rezulton me këto të dhëna.

- Kapitali themeltar prej 7.976.136.000,00 Lekë;
- Numri i aksioneve 7.976.136,00 aksione;
- Vlera nominale e një aksioni 1.000,00 Lekë secila

Shoqëria "Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr. 3" Sh.a. do të jetë dorëzuese e kontributit pranë shoqërisë "Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1" Sh.a., në datën e realizimit përfundimtar të operacionit të bashkimit me përthithje.

#### IV. Mënyra e dorëzimit të pjesëve të kapitalit

Dorëzimi i pjesëve të kapitalit do të behet pranë shoqërisë "Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1" Sh.a., pas regjistrimit të ndryshimit në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe marrjen e miratimit të fazës së dytë të bashkimit me përthithje që prezumon dhe përfundimin e këtij procesi. E drejta për të marrë dividend fillon që nga veprimtaria ekonomike e vitit 2020.

Në aspektin kontabël të gjitha operacionet e veprimtarisë të kryera prej shoqërisë "Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr. 3" Sh.a., nga data 31.12.2019 deri në datën e realizimit të bashkimit do të konsiderohen si të kryera nga shoqëria përthithëse "Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1" Sh.a. dhe regjistrimet përkatëse kontabël do të merren në librat kontabël të saj.

Data në të cilat janë hartuar llogaritë e shoqërive të interesuara që do të përdoren për të formuluar kushtet e operacionit të bashkimit me përthithje.

Llogaritë që janë përdorur për të përcaktuar kushtet financiare të bashkimit me përthithje janë hartuar duke iu referuar datës 31.12.2019 si për shoqërinë përthithëse, ashtu edhe për shoqërinë e përthithur.

#### VI. Raporti i këmbimit të të drejtave në shoqëri.

Sipas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të dy shoqëritë kanë si pronare/Aksionar të Vetëm Bashkinë Tiranë..

Në këto kushte kapitali i bashkuar nga të dy shoqëritë ka si pronare/Aksionar të Vetëm Bashkinë Tiranë.

Sipas bilanceve të dy shoqërive të vitit 2019 gjendja e kapitaleve të nënshkruara paraqitet si më poshtë:

RSU Nr. 1	-	Lekë 7.976.136.000,00	7.976.136,00	aksione, me vlerë nominale 1.000,00
NTS Nr. 3	-	Lekë 154.743.000,00	154.743,00	aksione, me vlerë nominale 1.000,00

Kapitali i përbashkët Lekë 8.130.879.000,00 8.130.879,00 aksione, me vlerë nominale 1.000,00 Lekë.

Në këto kushte Aksioneri i Vetëm Bashkia Tiranë, pavarësisht nga rezultatet e transaksioneve të vitit 2020 deri në datën e bashkimit pranon që si kapital i nënshkruar të mbetet shuma prej 8.130.879.000,00 Lekë, me një numër prej 8.130.879,00 aksione, me vlerë nominale 1.000,00 lekë.

## **VII. Efektet mbi punëmarrësit**

RSU Nr.1 do të konsiderohet pala përgjegjëse për çdo detyrim të palshlyer nga NTS Nr. 3 për punonjësit para datës së ekzekutimit/bashkimit. Pas datës së ekzekutimit, Shoqëria RSU Nr.1 do të marrë masa për të vijuar marrëdhëniet e punësimit me punëmarrësit e Shoqërisë NTS Nr.3 sh.a brënda kapaciteteve teknike, kërkesave operacionale dhe mundësive financiare të Shoqërisë.

## **VIII. Efektet mbi organet drejtuese të "Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1" Sh.a. pas përthithjes**

Bashkimi me përthithje nuk do të sjellë asnjë ndryshim në organet drejtuese të "Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1" Sh.a.. Në datën e ekzekutimit të bashkimit, anëtarët e organeve drejtuese të "Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1" Sh.a., do të konsiderohen anëtarët e organeve të shoqërisë përthithëse.

## **IX. Efektet ligjore të bashkimit**

Në bazë të nenit 220, pika 3 e Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", regjistrimi i bashkimit të shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit:

- a) ka pasojë kalimin të shoqëria perthithese të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që perthithet. Ky transferim ka pasojë si në marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, ashtu edhe të palet e treta;
- b) ben që aksionaret apo ortakët e shoqërisë se perthithur të behen aksionare apo ortake të shoqërisë perthithese;
- c) ben që shoqëria që perthithet të vleresohet e prishur, ndaj çregjistrohet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, pa kaluar në procesin e likuidimit. Personalitet juridik do të vazhdojë të ketë vetëm shoqëria përthithëse Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1" Sh.a..

## **X. Shuma e parashikuar të primit të bashkimit me përthithje**

Meqenëse bashkimi i të dy shoqërive ka të bëjë me të njëjtin Aksioner nuk lind problemi i krijimit të primeve.

### **4. Zgjidhja e Projekt-marrëveshjes**

Kjo marrëveshje mund të zgjidhet në çdo kohë përpara datës së ekzekutimit (bashkimit), me miratimin e dhënë me shkrim nga të dyja palët.

### **5. Ligji i zbatueshëm dhe Forca madhore**

Kjo marrëveshje, në tërësi, do të qeveriset nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë.

Palët nuk mund të deklarohen përgjegjëse për mospërbushjen e detyrimeve respektive, kur kanë qenë nën ndikimin e një force madhore e cila ka ndikuar drejtpërdrejtë në ekzekutimin dhe mbarëvajtjen normale të përmbajtjes së kësaj marrëveshjeje, për atë kohë sa do të vazhdojë të jetë në ndikimin e kësaj force dhe për atë sa janë ndikuar në ekzekutimin e detyrimit përkatës.

Forca madhore do të konsiderohen të gjitha faktet dhe rrethanat që dalin jashtë kontrollit normal dhe të arsyeshëm të palëve dhe kanë ndikuar objektivisht në zbatimin e kësaj marrëveshjeje ose pjesëve të caktuara të saj.

Me përfundimin e periudhës së ndikimit apo efekteve të Forcës madhore palët do të vazhdojnë me ekzekutimin normal të kësaj marrëveshjeje sipas përmbajtjes.

Do të konsiderohen forca madhore (jo në mënyrë shteruese) turbullirat civile, lufta, grevat, shaktërrimet nga katastrofat natyrore, pandemitë, çdo lloj akti ligjor dhe nënligjor miratuar pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje që ndikon drejtpërdrejt në ekzekutimin normal të kësaj marrëveshjeje etj..

## **6. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe gjykata kompetente**

Palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve që mund të lindin nga ekzekutimi i kësaj mos-marrëveshjeje.

Në qoftë se mirëkuptimi sipas paragrafit të parë të këtij neni nuk mund të arrihet, autoriteti kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## **7. Të ndryshme**

Çdo ndryshim i kësaj projekt-marrëveshjeje do të jetë i vlefshëm vetëm nëse është bërë me shkrim dhe është nënshkruar nga palët.

Ky operacion bashkimi nuk do të përmbajë as të drejta dhe as ndonjë avantazh të veçantë. Ky projekt bashkimi hartohet e nënshkruhet me kushtin e varësisë së miratimit nga organi kompetent i secilës prej shoqërive pjesëmarrës.

Hartuar në Tiranë, më 28.07.2020

**Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1**  
Përfaqësuar nga Administratori

**Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr. 3**  
Përfaqësuar nga Administratori




"Rezidenca Studentore Universitare Nr. 1" Sh.a.

"Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr. 3" Sh.a

Anila Shehu



Ndue Ndoci





REZIDENCA STUDENTORE  
UNIVERSITARE NR.1 SH.A

Nr. 2 Prot.

Datë 06.01.2021

BASHKIA  
TIRANË  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 6383 prot.

Tiranë, më 31.12, 2020

Lënda: **Dërgim vendimesh**

**REZIDENCËS STUDENTORE UNIVERSITARE NR.1 SHA**

E nderuar Znj. Anila Shehu, Drejtore

Bashkëlidhur, Ju dërgojmë Vendimin e miratuar nga Këshilli Bashkiak Tiranë realizuar në mënyrë elektronike me datë **18 Dhjetor 2020**, në zbatim të Aktit Normativ Nr.3 dt.15.03.2020 të Këshillit të Ministrave "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19" i ndryshuar, pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresë protokoll nr. 1935/11, datë 30.12.2020 si më poshtë:

1. **Vendim nr.164 datë 18.12.2020**, "Për zmadhimin e kapitalit, për shoqërinë aksionare "Rezidenca Studentore Universitare nr.1" sh.a, në pronësi të Bashkisë Tiranë".

SEKRETAR

Behar Zeneli





BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 164, datë 18.12.2020

P Ë R

ZMADHIMIN E KAPITALIT PËR SHOQËRINË AKSIONARE "REZIDENCA  
STUDENTORE UNIVERSITARE NR.1" SH.A, NË PRONËSI TË BASHKISË  
TIRANË

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja "b" dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 81, pika 1, shkronja "e", të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për regjistrimin e biznesit", të ndryshuar, vendimit nr. 335, datë 04.05.2016, të Këshillit të Ministrave "Për transferimin e 100% të aksioneve të shoqërive aksionare "Rezidenca Studentore nr. 1" sh.a., Tiranë, "Trajtimi i Studentëve nr.2" sh.a. Tiranë dhe "Trajtimi i Studentëve nr. 3" sh.a. Tiranë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes tek Bashkia Tiranë", vendimit nr.45, datë 29.04.2020, të Këshillit Bashkiak "Për nisjen e procedurave të bashkimit me përthithje të shoqërisë "Ndërmarrja e Trajtimin të Studentëve nr. 3" sh.a nga shoqëria përthithëse "Rezidenca Studentore Universitare nr. 1", sh.a Tiranë; vendimit nr. 157, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020", të ndryshuar, kërkesës së shoqërisë "Rezidenca Studentore Universitare nr. 1, Sh.a me nr. 1541/1prot., datë 12.10.2020, si edhe në vijim të memos 42810 prot, datë 04.12.2020 "Mbi rritjen e kapitalit të shoqërisë "Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 sh.a", me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak, në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "Rezidenca Studentore nr. 1" sh.a,

V E N D O S I:

1. Zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Rezidenca Studentore Universitare nr. 1," Sh.a. me anë të emefimit të aksioneve të reja nga aksioneri i vetëm Bashkia Tiranë, në vlerën prej 43,448,849 lekë (dyzet e tre milion e katërqind e dyzet e tetë mijë e tetëqind e dyzet e nëntë) lekë, me vlerë nominale 1000 (njëmijë) lekë secili aksion, duke e rritur numrin e përgjithshëm të aksioneve në 8,174,327.849 (tetë milionë njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e njëzet e shtatë dhe tetëqind e dyzet e nëntë) lekë, si edhe vlerën e përgjithshme të kapitalit në shumën 8,174,327,849 (tetë miliard e njëqind e shtatëdhjetë e katër milion e treqind e njëzet e shtatë mijë e tetëqind e dyzet e nëntë) lekë.
2. Zmadhimi i kapitalit të pasqyrohet në nenin përkatës të Statutit të shoqërisë "Rezidenca Studentore Universitare nr. 1," Sh.a si dhe të regjistrohet në Regjistrin e Aksioneve të shoqërisë.
3. Ngarkohen administratori i shoqërisë që të njoftojë për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit vendimin për zmadhimin e kapitalit.






4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga fondet e miratuara në Programin e Zhvillimit, art 232 parashikuar në buxhetin e Bashkisë Tiranë për vitin 2020.

5. Ngarkohen shoqëria Rezidenca Studentore Universitare nr. 1," Sh.a dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

KRYETAR

ROMINA KUKO



E nderuar Znj. Anila Shehu, Drejtore

Bashkëdhëmbur, Ju dërgojmë Vendimin e miratuar nga Këshilli Bashkiak Tiranë realizuar në mënyrë elektronike me datë 18 Dhjetor 2020, në zbatim të Aktit Normativ Nr.3 dt.15.03.2020 të Këshillit të Ministrave "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së penadhes së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19" i ndryshuar, pas konfirmimit të ligshmërisë nga Prefekti i Qarkut Tiranë me aktin protokoll nr. 1595/14 datë 30.12.2020 si më poshtë:

1. Vendimi nr.164 datë 18.12.2020, "Për marrëmbimin e kapitalit, për shoqëri aksionare "Rezidenca Studentore Universitare nr.1" sh.a. në procesin të Bashkisë Tiranë".

SEKRETAR

Behar Zogaj

